DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 0204-358/7
-VI- Date / Datum / Date 21.07.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Qendron Kastrati,** Kryetar i Komunës së Kamenicës<br>**Albert Sermaxhaj,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić** Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>20.07.2020<br>0204-358/6 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>**Edmond Kuka**, Zyrtar për monitorim të komunave për | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kamenicës | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Sh/01 Nr.6963/27.02.2015 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës. |
| I miratuar më datë: 29.06.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 03.07.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**. Ndërsa sa i përket aspektit përmbajtësor mbetet në përgjegjësinë e komunës së Kamenicës, për ta udhëzuar palën për mjetet juridike për t'ju drejtuar gjykatës kompetente. Dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204- 358/7
-VI-
Data Datum Date 21.07.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne prave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | **Qendron Kastrati**, gradonačelnik opštine Kamenica<br>**Albert Sermaxhaj**, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Goran Rakić**, zamenik premijera i ministar MLS<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka MLS | |
| Od: | **Venera Qerkini**, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MLS | Datum,<br>13.07.2020<br>03.07.2020 |
| Odgovorni službenici:<br>1.Službenik za utvrđivanje zakonske procene<br>2.Službenik-ca za izradu zakonske procene | **Xhevat Tafa**, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština<br><br>**Edmond Kuka**, službenik za montorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Kamenica | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Ministarstvo lokalne uprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka o izmeni i dopuni Odluke Š/01 Nr.6963/27.02.2015 Skupštine opštine Kamenica |
| Usvojena dana, 29.06.2020. godine, |
| Predložena za razmatranje u MLS, dana, 03.07.2020. godine, |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu **u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi,** Što se tiče suštinskog aspekta, ostaje odgovornost na opštini Kamenica, da naloži stranci o pravnim sredstavima da se obrati nadležnom sudu, i kao takav može proizvesti pravni efekat.
Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 01 Nr. 13486
Nr. i faq. 02 Data: 03/07/2020
KAMENICË/A

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 03.07.2020
-01- 204- 3578/6

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**KUVENDI I KOMUNËS-KAMENICË**
**Nr.07/ 03.07.2020**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt:20.02.2018, nenit 7.2 pika b, të Statutit të Komunës së Kamenicës nr.01.005/2008 e datës 26.09.2008, dhe Propozim Vendimit për shfuqizimin e pjesëshëm të vendimit Sh.01.Nr.6963/27.02.2015 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës Sh.02.Nr.12475/22.06.2020, Kuvendi Komunal në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.06.2020 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT Sh.01 Nr.6963/27.02.2015 TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS

1. Me nenin (I) të këtij vendimi plotësohet dhe ndryshohet neni (II) i Vendimit Sh.01 Nr.6963/27.02.2015 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër për pesëmbdhjetë (15) vite, që ka të bëj me ngastren kadastrale –P-71107041-01075-1, sip.=275313 m2, Z.K Kamenicë, PSH Kuvendi Komunal Kamenicë, vendi i quajtur "Shiroka Llazina – Ravniste" klasa e (6) gjashtë.

2. **MBETET NË FUQI** pjesa tjetër e Vendimit Sh.01 Nr.6963/27.02.2015 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër në (15) pesëmbdhjetë vite.

3. Komisioni komunal i caktuar me vendim nga Kryetari i komunës, për vlerësimin e zbatimit të kontratave për pronat e paluajtshme komunale të dhëna në shfrytëzim me qera, ka konstatuar se Qeramarrësi-Kontraktuesi i pronës si në pikën një (1) të këtij Propozim – Vendimi, Z. Fadil (Feti) Shillova nga Kamenica, **nuk i ka përmbushur obligimet** e parapara sipas nenit (2) dy të kontratës Sh.02 Nr 17430/dt.11.06.2015, andaj edhe ka ardhë deri te marrja e vendimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës Sh.02. Nr.17430 datë 11.06.2015.

4. Vendimit i bashkangjesim: Vendimin Sh.01 Nr.6963 datë 27.02.2015 i Kuvendit të Komunës, Kontrata Sh.02. Nr.17430 datë 11.06.2015 për qeranë e shfrytëzimit të tokës së paluajtëshme komunale, Procesverbali datë 21.082019 i komisionit për vlerësimin dhe zbatimin e kontratave, Njoftimi Sh.02 36034 datë 15.11.2019, si dhe vendimit Sh.02 Nr.36553 dt.22.11.2019 për shkëputjen e njëanshme të kontratës Sh.02. Nr.17430 datë 11.06.2015 për qeranë e shfrytëzimit të tokës së paluajtëshme komunale.

5. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

**I dorëzohet**: Zyrës së Kryetarit të Komunës,MAPL-së, Zyra e Kuvendit, Zyrës për përkthime ,Drejtorisë për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi QSHQ-së.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Albert Sermaxhaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 13486
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 03/07
KAMENICË/A 2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**SKUPŠTINA OPŠTINE-KAMENICA**
**Br.07/Datum: 03.07.2020**

Na osnovu člana 12 stav 12.2 slovo d), člana 14 stav 14.1 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 od 20.02.2018, člana 7.2 tačka b, Statuta Opštine Kamenica Š br.01.005/2008 od 26.09.2008, i Predlog Odluke o delimičnom ukidanju odluke Š 01, Br.6963/27.02.2015 Skupština Opštine Kamenica Š 02, Br.12475/22.06.2020, Skupština Opštine na redovnoj sednici održanoj: 29.06.2020 usvojila ovu:

## ODLUKU

## O IZMENAMA I DOPUNAMA ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE KAMENICA Š 01 Br.6963/27.02.2015

1. Članom (I) ove odluke dopunjuje i menja se član (II) Odluke Skupštine Opštine Kamenica, Š 01, Br.6963/27.02.2015 za kratkoročno davanje opštinske imovine za petnaest (15) godina, koja se odnosi katastarske parcele –P-71107041-01075-1, pov.=275313 m$^2$, K.Z.Kamenica, DS Skupština Opštine Kamenica, mesto zvano "Široka Lazinna – Ravnište" (6) šesta klasa.

2. **OSTAJE NA SNAZI** ostali deo Odluke Skupštine Opštine Kamenica Š 01 Br.6963/27.02.2015 za kratkoročno davanje na korišćenje opštinske imovine na (15) petnaest godina.

3. Opštinska komisija odlukom Predsednika Opštine, određena o proceni sprovođenja ugovora za opštinske nepokretne imovine koje su date u zakup na korišćenje, zaključila da je Iznajmljivač-Ugovarač imovine kao u tački jedan (1) ove Predlog Odluke, g. Fadil (Feti) Shillova iz Kamenice, **nije ispunio obaveze** predviđeno članom (2) dva ugovora Š 02 Br 17430/od 11.06.2015, stoga i došlo se do donošenja odluke za jednostrano ukidanje ugovora Š 02. Br.17430 od 11.06.2015.

4. Odluci prilažemo: Odluku Skupštine Opštine Š 01 Br.6963 od 27.02.2015, Ugovor Š 02, Br.17430 od 11.06.2015 o zakupnini za korišćenje opštinske nepokretne imovine, Zapisnik komisije za procenu ugovora od 21.082019, Obaveštenje Š 02 36034 od 15.11.2019, i odluku Š 02 Br.36553 od 22.11.2019 u jednostranom ukidanju ugovora Š 02, Br.17430 od 11.06.2015 o zakupu za korišćenje opštinske nepokretne imovine.

5. Ova odluka na snagu stupa 7 dana nakon objavljivanja na opštinskoj službenoj stranici.

**Dostaviti:** Kancelariji Predsednika Opštine, MALJS-a, Kancelariji Skupštine, Kancelariji prevođenja, Odeljenju za Imovinu, Katastar i Geodeziju, GUCO-e.

**RAI./Pr.**

**Predsedavajući Skupštine**

**Albert Sermaxhaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**Sh.02 Nr.253 /12.11.2019**

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunë Komunës (Ligji nr.06/L-092), në bazë të vendimit Sh.01. nr. 12527 e datës 27.02.2015 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për qiranë e shfrytëzimit të tokës së paluajtshme Komunale, 1.nr.P-71107041-01075-1 në sipërfaqe prej 275313 $m^2$, nenit 4 në lidhje me nenin 2 të Kontratës me numër Sh.02.nr.17430, pastaj procesverbalit të datës 21.08.2019 nga Komisioni për Verifikimin dhe Zbatimin e Kontratave për Dhënien e Pronave Komunale të Dhëna në shfrytëzim, i emëruar në bazë të Vendimit Sh.02. Nr. 12527/dt.02.05.2019, Kryetari i Komunës së Kamenicës, më datë 12.11.2019 nxjerr,

**NJOFTIM**

**PËR SHKËPUTJEN E NJËANSHME TË KONTRATËS PËR QIRANË E SHFRYTËZIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE**

1. **SHKËPUTET** kontrata Sh.02. Nr.17430/dt 11.06.2015 për qiranë e shfrytëzimit të tokës së paluajthsme komunale e lidhur në mes të Komunës së Kamenicës si qiradhënëse në njërën anë, dhe në anën tjetër nga z. Fadil (Feti) Shillova nga Kamenica në cilësinë e qiramarrësit të tokës së paluajtshme komunale.

2. Komisioni për verifikimin dhe zbatimin e kontratave për dhënien e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, me datë 21.08.2019 ka dalen në terren dhe ka **konstatuar** se qiramarrësi **nuk i ka përmbushur** obligimet e parapara sipas nenit 2 të kontratës Sh.02.nr.17430/dt.11.06.2015.

**T'i dorëzohet:**

Qiramarrësit,Komisionit komunal për verifikimn dhe zbatimin e kontratave për dhënien e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim,DPKGJ-së,Kuvendit të Komunës, dhe QSHQ-së-arkivi

**Kryetari i Komunës**

**Qëndron Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Komisioni për Vlersimin e Zbatimit të Kontratave**
**Datë:21.08. 2019.**

Në bazë të Vendimit Sh.02,Nr.12527 të datës 02.05.2019 , Komisioni ka dalë në vend të ngjarjes 06.06.2019 dhe ka hartuar këtë :

## PROCESVERBAL

Nga dalja në teren me datë:21.08.2019 te personi fizik z. Fadil Feti Shillova, si shfrytëzues i pronës Komunale vendi I quajtur "SHiroka Llazina-Ravnishte", Komisioni konstaton se shfrytezuesi i lartë cekur nuk i ka përmbush obligimet e parapara me kontrate: zhvillimin e veprimtarise-Kompleksit te Fermave te Kombinuara, te Lopeve Qumeshtore, Gjedhave, Deleve, Dhive, njeherit ndertimin e objektit te perkohshem montazh per vendosjen e tyre, mbjellur me miser, grure, patate, terfoje dhe bari te kultivuar.

Këtij procesverbali i'a bashkangjesim foton e prones dhe kopjen e kontratës.

| **Komisioni .** | **Nënshkrimi :** |
|---|---|
| 1. Ruem [illegible] | [illegible] |
| 2. Fadil Hodi | [illegible] |
| 3. Arif Skoverosh | [illegible] |
| 4. Ferat Voksh | [illegible] |
| 5. Beletesh Domonti | [illegible] |

Tezd. Feti Shillova

02 17430
2 11/6
2015

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Në bazë të nenit 14, 58 h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3 pika 1.3 dhe 1.4, nenit 5,6 dhe 7 të Ligjit nr.03/L-144 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtëshme të Komunës,Raportit të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Tenderëve nr. 653-15-007 i d.t 31.03.2015, Vendimit të Kuvendit Komunal të Kamenicës Sh.01 Nr. 6963 i d.t. 27.02.2015, si dhe dispozitave nenit 13.1,2 nenit 23.12,3.4 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14, lidhet:

# KONTRATË
# PËR
# QIRANË E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE

Hartuar më 11.06.2015 , në Kamenicë , në mes:
1.Komunës së Kamenicës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës **z. Begzad Sinani** në njërën anë në cilësi të Qiradhënësit të tokës së paluejtëshme Komunale, dhe
**2.Fadil Feti Shillova** ( person Fizik)- nga Kamenica në cilësinë e Qiramarrësit të tokës së paluajtëshme Komunale , në anën tjetër.

## Dispozitat e përgjithshme

## Neni 1.

Kuvendi i Komunës së Kamenicës më d.t. 27.02.2015 miratoi Vendimin Sh.01 nr.6963 për Dhënjen e Pronës së Paluajtëshme Komunale në shfrytëzim afatëshkurtës prej 15 viteve me qira,me qëllim të jetësimit të projektit –zhvillim i veprimtarisë-biznesit-Kompleksit të Fermave të Kombinuara,të Lopëve Qumështore, Gjedhave, Deleve e Dhive, njëherit ndërtimin e një objekti të përkohshëm-montazhë për vendosjen e tyre,mbjellur me miser, grurë, patate, tërfojë dhe bari të kultivuar,ngastra kadastrale:
1.nr. P-71107041-01075-1 , sip= **275313 m²**, vendi i quajtur "Shiroka Llazina-Ravnishte",lloji i shfrytëzimit të pronës-Bujqësore, shfrytëzimi aktual-Arë e klasës 6, e cila në Zyrën Komunale Kadastrale në Kamenicë evidencohet në emër të P.SH.KK.Kamenicë, për Z.K.Kamenicë.

Qiradhënësi e jep në shfrytëzim paluajtëshmërinë Qiramarrësit, ngastrën kadastrale , me sipërfaqe të përshkruara si më lartë për qëllimin e jetësimit të Projektit zhvillim i veprimtarisë-biznesi – Kompleksit të Fermave të Kombinuara,të Lopëve Qumështore, Gjedhave, Deleve e Dhive, njëherit ndërtimin e një objekti të përkohshëm-montazhë për vendosjen e tyre, dhe mbjellur me miser, grurë, patate, tërfojë dhe bari të kultivuar , e për të cilën pronë është llogaritur edhe qmimi i qirasë vjetore prej **912.5o € ose 912.5o € x 15 vite = 13681.50 €.**

Kontrata mundë të shkëputet edhe në bazë të vullnetit të njëanëshëm të Qiramarrësit i cili sipas kësaj pajtohet, dhe tërhiqet edhe nga e drejta e ngritjes së padisë dhe kompenzimit të qfardo kërkesëpadie .

**Dispozitat e veqanta**

**Neni 5.**

Në rastë të kolizionit të dispozitave përkatëse të kësaj kontrate me ligjin përkatës do të vlejnë drejtë për së drejti dispozitat përkatëse nga ligjet që përligjojnë pronën e paluajtëshme komunale dhe shfrytëzimin apo menaxhimin e saj, dispozitat e Ligjit për Marrëdhënet Detyrimore,si dhe rregullat tjera të së drejtës kontraktuese, të cilat dispozita ligjore do të kenë zbatim të drejtë për drejtë edhe në rastet kur kjo kontratë nuk mbulon të gjitha rrethanat juridike dhe faktet e rastit lëndor.

Neni 6.

Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës për shfrytëzimin e pronës publike Komunale, të paraqitet në Drejtorinë për Pronësi Kadastër dhe Gjeodezi-Zyrën Komunale Kadastrale, të e regjistroi të drejtën e shfrytëzimit sipas afatit të përcaktaur në nenin 2 të kësaj kontrate.

Neni 7.

Kontestet eventuale sipas kësaj kontrate ,palët kontraktuese apriori do të bëjnë përpjekje që të i zgjidhin bashkarisht , në të kundërtën kompetente për vendosje të më tutjeshme do të jetë Gjykata Themelore-Dega në Kamenicë.

Neni 8.

Kontrata mbi qiranë e tokës publike komunale, hynë në fuqi atëherë kur palët kontraktuese-Qiramarrësi dhe Qiradhënësi e nënshkruajnë.

Neni 9.

**Pjesë përbërëse e kësaj kontrate janë:**

1.Qertifikata Pronësore për ngastrën kadastrale:
nr. P-71107041-01075-1 sip= 275313 m² Z.K.Kamenicë P.SH.KK.Kamenicë.
2.Kopja e Planit për ngastrën kadastrale si më lartë,
3. Vendimi i Kuvendit Komunale Sh.01. Nr. 6963 i d.t. 27.02.2015.
4. Vendimi i Drejtoruisë për Financa dhe Buxhet për ngarkesën e qirasë së shfrytëzimit të tokës komunale .
5. Projekti Detal i Fadil Feti Shillovës (person fizik)-zhvillim i veprimtarisë-biznesi, është jetësimi i Projektit- zhvillim i veprimtarisë-biznesi Kompleksit të Fermave të Kombinuara,të Lopëve Qumështore, Gjedhave, Deleve e Dhive, njëherit ndërtimin e një objekti të përkohshëm-montazhë për vendosjen e tyre, dhe mbjellur me miser, grurë, patate, tërfojë dhe bari të kultivuar.

Neni 10.

Kjo kontratë është hartuar në ekzemplarë- kopje të mjaftuara identike prej të cilave nga një kopje e marrin palët kontraktuese, ndërsa nga një kopje mbesin tek Drejtoria për Pronësi Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Financa dhe Buxhet, një në arkivin Komunal.

**PALËT KONTRAKTUESE**

| Qiramarrësi | Qiradhënësi |
|---|---|
| Fadil Feti Shillova, nga Kamenica | KOMUNA E KAMENICËS |
| | Kryetari |
| | Begzad Sinani |
| Nr. përs në DI-1012094457 | |
| Lëshuar nga MPB .R e Kosovës | |



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 6963
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 4/3
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 10, 14 dhe 46 të Statutit të komunës, Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, rregullores nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës si dhe propozim-vendimi Sh.02 nr.5218 dt.18.02.2015 , Kuvendi i Komunës së Kamenicës me datë 27.02.2015 mori,

## VENDIM

## PËR LEJIMIN E DHËNJES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUJTËSHME TË KOMUNËS- PERSONAVE FIZIK DHE JURIDIK DUKE PASUR PARASYSHË INTERESIN PUBLIK KOMUNAL-KAMENICË

I. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2015 miratoi vendimin për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër në 15 vite e cila bëhet përmes ankandeve publike, personave fizikë/juridik duke pasur parasysh interesin publik Komunal-me kompensim-Qera

II. Pronat e paluajtëshme të propozuara për dhënie në shfrytëzim , janë të harmonizuara me Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenicës , janë:

- P-71107008-00326, sip=68743 m² dhe P-71107008-00325, sip=28631 m²
- P-71107008-00268 ,sip=163843 m² Z.K.Bratilloc, P.SH.Kuvendit Komunal.
- P-71107071-00116, sip=218373 m² Z.K.Strelicë, P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.
- P-71107079-01212, sip=80780 m²,P-71107079-00308, sip=9996 m²,- P-71107079-00336, sip=4117 m², P-71107079-00474-2 sip=11760 m², P-71107079-00558-2,sip= 22685 m² Z.K.Qarakoc, P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.
- P-71107041-01075-1, sip= 275313 m², Z.K.Kamenicë,P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.
- P-71107026-00061, sip= 53231 m², P-71107026-00063, sip=44088 m², Z.K.Dajkoc, P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.
- P-71107009-00593, sip=23975 m², P-71107009-00887, sip=17904 m², Z.K.Busavatë, P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.
- P-71107004-00003, sip=42560 m², P-71107004-00004, sip=94340 m²,P-71107004-00005, sip=63100 m², Z.K.Bllatë ,P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë.

III.Obligohet komisioni vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për fillimin e procedurave, respektivisht shpalljen e ankandit publik për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

IV.Komisioni punën e vet e mbështet duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-144 si dhe Rregulloren QRK-së nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.







